



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.71, datë 10.11.2006

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS TË NJË PRONË TË PALUAJTSHME SHETËTORË TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.69, DT.20.12.2005 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË CILAT JANË NË TERRITORIN NËN JURIDIKSIONIN E BASHKISË SË TIRANËS” TË FONDER MEK SH.A. TERRITORI I SË CILËS DO TË PËRDORET PËR NGRITJEN E DISA BANESAVE SOCIALE

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, Ligjit Nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimit Nr.3, datë 18.7.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimit Nr.15, datë 30.6.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, pika 1/a, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.378, datë 12.8.1999 “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike organeve të qeverisjes vendore”, pika 2, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së transferimit të Fonder Mek sh.a. pronë e cila do të përdoret për ndërtimin e disa banesave sociale në kuadër të strategjisë së strehimit.
2. Dërgimin e kësaj kërkesë për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Aseteve, Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI